

<b>SQ</b>	Udhëzimet për përdorim	2
<b>RU</b>	Инструкция по эксплуатации	16

Frigorifer-Ngrirës  
Холодильник-морозильник

# USER MANUAL

# Përmbajtja

Udhëzime për sigurinë _____	2	Kujdesi dhe pastrimi _____	8
Funksionimi _____	4	Si të veprojmë nëse... _____	9
Përdorimi i parë _____	5	Të dhëna teknike _____	11
Përdorimi i përditshëm _____	5	Instalimi _____	11
Udhëzime dhe këshilla të nevojshme _____	6	Çështje që lidhen me ambientin _____	15

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

## Udhëzime për sigurinë

Në interes të sigurisë tuaj si dhe për një përdorim të saktë, përpara se të instaloni dhe të përdorni për herë të parë pajisjen, lexoni me kujdes këtë manual të përdoruesit, duke përfshirë këshillat dhe paralajmërimet. Për të shmangur gabime dhe aksidente të panevojshme, është e rëndësishme që të gjithë personat që do të përdorin këtë pajisje, të njohin mirë mënyrën e përdorimit dhe veçoritë e sigurisë. Ruajini këto udhëzime dhe sigurohuni që t'i bashkëngjiten pajisjes në rast se do ta falni apo do ta shisni atë, në mënyrë që kushdo që do ta përdorë gjatë jetëgjatësisë së saj, të jetë i mirinformuar për përdorimin e pajisjes dhe sigurinë ndaj saj. Për sigurinë e jetës dhe pronës, zbatojni masat paraprake të udhëzimeve të përdorimit, pasi prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëmtime të shkaktuara nga pakujdesia.

### **Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme**

- Kjo pajisje nuk është përshtatur për përdorim nga personat (përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore apo mendore, ose me mungesë përvoje dhe njohurish, për sa kohë nuk janë të mbikëqyrur apo janë udhëzuar si të përdorin pajisjen nga një njeri përgjegjës për sigurinë e tyre. Fëmijët duhet të mbikëqyren për t'u siguruar që nuk luajnë me pajisjen.
- Mbajini të gjitha materialet e paketimit larg fëmijëve. Ka rrezik asfiksioni.
- Nëse do ta hidhni pajisjen, hiqni spinën nga priza, pritni kabllon e ushqimit (sa më pranë pajisjes sa të mundeni) dhe hiqni

derën për të parandaluar fëmijët që luajnë të pësojnë ndonjë goditje elektrike apo të mbyllën vetë brenda.

- Nëse kjo pajisje që përmban brava magnetike të derës do të vendoset në vend të një pajisjeje të vjetër me bravë në trajtë suste (shul) mbi derë apo mbi kapak, sigurohuni që ta shkatërroni atë bravë përpara se të hidhni pajisjen e vjetër. Kjo do të parandalojë që pajisja të kthehet në rrezik vdekjeje për fëmijët.

### **Siguria e përgjithshme**

#### Paralajmërim

Mos i bllokoni vrimat e ventilimit në karkasën e pajisjes ose në strukturën inkaso.

- Pajisja është ndërtuar për të mbajtur ushqime dhe/ose pije në shtëpi dhe për përdorime të ngjashme, si p.sh.:
  - në zonat e kuzhinës për personelin në dyqane, në zyra dhe në ambiente të tjera pune;
  - në ferma dhe nga klientët në hotele, motele dhe ambiente të tjera banimi;
  - në ambiente me fjetje dhe mëngjes;
  - në catering dhe përdorime të ngjashme jo për shitje.
- Mos përdorni asnjë pajisje mekanike apo mjete artificiale për të përshpejtuar shkrijen e akullit.
- Mos përdorni pajisje të tjera elektrike (si makinë akulloresh) brenda pajisjeve ftohëse, për sa kohë që nuk janë përshtatur për këtë nga prodhuesi.
- Mos e dëmtoni qarkun e lëndës ftohëse.

- Gazi ftohës (izobutani) (R600a) që ndodhet në qarkun ftohës të pajisjes, është një gaz natyror me një nivel të lartë pajtueshmërie me ambientin, por që është gjithsesi i ndezshëm. Gjatë transportimit dhe instalimit të pajisjes, sigurohuni që asnjë nga pjesët e qarkut ftohtës të mos dëmtohet. Nëse qarku ftohtës dëmtohet:
  - shmangni flakët e hapura dhe burimet ndezëse
  - ajrosni tërësisht dhomën në të cilën ndodhet pajisja
- Është e rrezikshme të ndryshoni specifikimet apo të përipieni ta modifikoni këtë produkt në çdo mënyrë të mundshme. Çdo dëmtim i shkaktuar në kablo mund të shkaktojë qark të shkurtër, zjarr dhe/ose goditje elektrike.



### **Paralajmërim** Çdo komponent elektrik (kablo i ushqimit, spina, kompresori)

duhet të zëvendësohet nga një agjent i certifikuar shërbimi ose nga një personeli i kualifikuar i shërbimit për të shmangur rreziqet.

1. Kablloja e ushqimit nuk duhet të zgjatet.
  2. Sigurohuni që spina nuk është shtypur apo dëmtuar nga pjesa e pasme e pajisjes. Një prizë e shtypur apo e dëmtuar mund të mbinxehet e mund të shkaktojë zjarr.
  3. Sigurohuni që priza e pajisjes të jetë lehtësisht e arritshme.
  4. Mos e tërhiqni spinën nga kablloja.
  5. Nëse priza e ushqimit është e liruar, mos futni në të spinën elektrike. Ka rrezik goditjeje elektrike ose zjarri.
  6. Nuk duhet ta vini në punë pajisjen pa kapakun e llambës (nëse është parashikuar) së ndriçimit të brendshëm.
- Kjo pajisje është e rëndë. Bëni kujdes kur e lëvizni atë.
  - Mos hiqni dhe mos prekni sende nga dhomëza e ngrirjes nëse i keni duart të

njoma, pasi kjo mund të shkaktojë dëmtim të lëkurës ose djegie të shkaktuara nga bryma/ngrirësi.

- Shmangni ekspozimin e gjatë të pajisjes në dritën e drejtpërdrejtë të diellit.
- Llambushkat (nëse janë parashikuar) e përdorura në këtë pajisje janë llamba të posaçme të përzgjedhura vetëm për përdorim në pajisje elektro-shtëpiake. Ato nuk janë të përshtatshme për t'u përdorur për ndriçim dhome.

### **Përdorimi i përditshëm**

- Mos vendosni enë të nxehta mbi pjesët plastike të pajisjes.
- Mos ruani brenda në pajisje gaz dhe lëng të ndezshëm, pasi këto mund të shpërthejnë.
- Mos vendosni produkte ushqimore drejtpërdrejt në zgavrën e daljes së ajrit që ndodhet në murin e pasmë. (Nëse pajisja është Pa formim bryme)
- Ushqimet e ngrira nuk duhet të ringrihen nëse janë shkrirë njëherë.
- Ushqimet e ngrira të paketuara paraprakisht, ruajini në pajisje sipas udhëzimeve të prodhuesit të ushqimit.
- Këshillat e prodhuesit të pajisjes për ruajtjen e ushqimeve, duhet t'i ndiqni me përpikmëri. Këshillohuni me udhëzimet përkatëse.
- Mos vendosni pije të gazuara ose shukumëzuese në dhomëzën e ngrirjes, pasi këto krijojnë presion brenda shishes dhe mund të shpërthejnë, gjë që do të dëmtojë pajisjen.
- Kubet e akullit mund të shkaktojnë djegie nëse konsumohen direkt nga pajisja.

### **Kujdesi dhe pastrimi**

- Përpara se të kryeni veprime për mirëmbajtjen e pajisjes, fikeni atë dhe hiqeni nga priza.
- Mos e pastroni pajisjen me objekte metalike.
- Mos përdorni objekte me majë për të hequr brymën nga pajisja. Përdorni një kruajtëse plastike.

- Kontrolloni rregullisht sistemin kullues të frigoriferit nëse ka mbetur në të ujë i ngrirë. Nëse është e nevojshme, pastroni filtrin e kullimit. Nëse tubi kullues është i bllokuar, uji do të mblihdet në fundin e pajisjes.

## Instalimi

**E rëndësishme** Për lidhjet elektrike ndiqni me kujdes udhëzimet e dhëna në paragrafët e veçantë.

- Shpaketoni pajisjen dhe kontrolloni nëse ka dëmtime. Mos e lidhni pajisjen nëse ajo është e dëmtuar. Raportoni menjëherë dëmtimet e mundshme në vendin ku keni blerë pajisjen. Në këtë rast, ruajeni paketimin.
- Është e këshillueshme të prisni të paktën katër orë përpara se të lidhni pajisjen, për t'i lejuar vajit të rrjedhë në kompresor.
- Rrotull pajisja duhet të ketë një qarkullim të mjaftueshëm të ajrit, pasi mungesa e tij do të shkaktonte mbinxehje. Për të arritur ventilim të mjaftueshëm, ndiqni udhëzimet përkatëse për instalimin.
- Aty ku është e mundur, pjesa e pasme e produktit duhet të vendoset pas murit për të shmangur prekjën ose kapjen e pjesëve të nxehta (kompresorit, kondensatorit), e për të shmangur djegie të mundshme.
- Pajisja nuk duhet vendosur pranë radiatorëve apo sobave.

## Funksionimi

### Ndezja

Futni spinën në prizën e murit. Rrotullojeni Rregullatorin e temperaturës në drejtim orar në një përzgjedhje mesatare.

### Fikja

Për të fikur pajisjen, rrotulloni rregullatorin e Temperaturës në pozicionin "O".

### Rregullimi i temperaturës



Temperatura rregullohet automatikisht. Për të venë pajisjen në funksionim, veproni si vijon:

- Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Lidhni vetëm me ujë të pijshëm (Nëse nuk parashikohet lidhja me ujin).


### Shërbimi

- Çdo ndërhyrje elektrike e nevojshme për instalimin e kësaj pajisjeje, duhet kryer nga një elektrikist i kualifikuar ose nga një person i aftë.
- Shërbimi i këtij produkti duhet të kryhet nga një Qendër e autorizuar Shërbimi, si dhe duhen përdorur vetëm pjesë këmbimi origjinale.

### Mbrojtja e Mjedisit

 Kjo pajisje nuk përmban gazra që mund të dëmtojnë shtresën e ozonit në qarkun e ftohësit apo në materialet izoluese. Pajisja nuk duhet të hidhet së bashku me plehrat e tjera të qytetit. Shkuma izoluese përmban gazra të ndezshëm: pajisja duhet të hidhet në përputhje me rregullat e zbatueshme të vendosura nga autoritetet tuaja lokale. Shmangni dëmtime në njësinë ftohëse, veçanërisht në pjesën e pasme pranë shkëmbyesit të nxehtësisë. Materialet e përdorura për këtë pajisje që kanë simbolin  janë të riciklueshme.

- rrotulloni Rregullatorin e temperaturës drejt një përzgjedhjeje më të ulët, për të përfutur minimumin e ftohtësisë.
- rrotulloni Rregullatorin e temperaturës drejt një përzgjedhjeje më të lartë, për të përfutur maksimumin e ftohtësisë.

 Një përzgjedhje mesatare është përgjithësisht përzgjedhja më e përshtatshme.

Gjithsesi, përzgjedhja e saktë duhet të zgjidhet duke mbajtur parasysh se temperatura brenda në pajisje varet nga:

- temperatura e dhomës
- shpeshësia e hapjes së derës
- sasia e ushqimit të depozituar
- vendndodhja e pajisjes.

**E rëndësishme** Nëse temperatura e ambientit është e lartë ose nëse pajisja është mbushur plot, dhe pajisja është vendosur në

## Përdorimi i parë

### Pastrimi i brendësisë së pajisjes

Përpara së të përdorni pajisjen për herë të parë, pastroni pjesën e saj të brendshme dhe gjithë aksesoret e brendshëm me ujë të vakët dhe pak sapun natyral për të hequr

## Përdorimi I përditshëm

### Ngrirja e ushqimeve të freskëta

Dhomëza e ngrirësit është e përshtatshme për ngrirjen e ushqimit të freskët si dhe për depozitimin e ushqimeve të ngrira për një kohë të gjatë.

Për të ngrirë ushqime të freskëta nuk është e nevojshme të ndryshoni përzgjedhjen mesatare.

Gjithsesi, për një proces më të shpejtë ngrirjeje, rrotulloni çelësin e temperaturës në një përzgjedhje më të lartë për të përfutur maksimumin e ftohtësisë.

**E rëndësishme** Në këto kushte, temperatura e dhomëzës së frigoriferit mund të bjerë nën 0°C. Nëse ndodh kjo, rivendoseni çelësin e temperaturës në një përzgjedhje më të ngrohtë.

Vendoseni ushqimin e freskët të ngrijë në dhomëzën e sipërme.

### Depozitimi i ushqimeve të ngrira

Kur e përdorni për herë të parë ose pas një periudhe jashtë përdorimit, përpara se të futni produkte në dhomëz, lëreni pajisjen të punojë për të paktën 2 orë në përzgjedhjen më të lartë.

Nëse ju duhet të fusni në pajisje sasi të mëdha ushqimi, hiqni gjithë sirtarët dhe koshat nga pajisja dhe vendosni ushqimin

temperaturën më të ulët, ajo mund të punojë pa pushim duke shkaktuar formimin e ngricës në murin e pasmë. Në këtë rast, rregullatori i temperaturës duhet vendosur në një përzgjedhje më të lartë për të lejuar shkrijen automatike dhe si rrjedhojë reduktimin e konsumit të energjisë.

erën tipike të një produkti të ri, e më pas thajeni tërësisht.

**E rëndësishme** Mos përdorni detergjent apo pluhura gërryese, pasi këto mund të dëmtojnë pjesët e lëmuara.

mbi raftet e ftohta për të patur rezultate sa më të mira.



**Paralajmërim** Sigurohuni që ushqimet të mos e tejkalojnë ngarkesën maksimale në anë të pjesës së sipërme (aty ku është e pranishme) ►

**E rëndësishme** Në rast të një shkrirjeje aksidentale, si për shembull për shkak të ikjes së korrentit, nëse ushqimi me energji ka zgjatur më shumë se vlera e treguar në tabelën e karakteristikave teknike në "koha në rritje", ushqimi i shkrirë duhet të konsumohet shpejt ose të gatuhet menjëherë e më pas të ringrihet (pasi është ftohur).

### Shkrirja e akullit

Ushqimet e ngrira, përpara se të përdoren, mund të shkrihen në dhomëzën ftohëse ose në temperaturën e dhomës, në varësi të kohës në dispozicion për këtë proces. Copëzat e vogla të ushqimit mund të gatuheshin edhe ndërsa janë ende të ngrira, direkt nga ngrirësi: në këtë rast, gatimi do të zgjasë më shumë.

### Prodhimi i kubeve të akullit

Kjo pajisje është e pajisur me një ose më shumë kuti të posaçme për prodhimin e

kubeve të akullit. Mbushini këto kuti me ujë, më pas futini në dhomëzën e ngrirjes.


**E rëndësishme** Mos përdorni vegla metalike për të hequr kutitë nga ngrirësi.

### Akumulatorët e ftohtësisë

Ngrirësi përmban të paktën një akumulator ftohtësie, i cili zgjat kohën e ruajtjes në së ftohtësisë, në rast të ikjes së korrentit apo një avarie.


### Raftet e lëvizshme

Muret e ftohësit janë të pajisura me një sërë shinash, në mënyrë që raftet të mund të vendosen sipas dëshirës.




### Vendosja e rafteve të derës

Për të lejuar ruajtjen e ushqimeve me madhësi të ndryshme, raftet e derës mund të vendosen në lartësi të ndryshme.





Tërhiqni gradualisht raftin në drejtim të shigjetave, derisa të lirohet, e më pas rivendoseni sipas dëshirës.



### Ftohja me ajër

Ventilatori i Ftohjes dinamike me ajër (DAC) bën që ushqimi të ftohet më shpejt dhe me një temperaturë më të njëtrajtshme brenda dhomëzës.

1. Ju mund ta ndizni ventilatorin duke shtypur butonin (1). Drita e gjelbër (2) ndizet.
2. Kthejeni rregullatorin e temperaturës në pozicionin e ventilatorit.



Ky mekanizëm ju mundëson ftohjen e ushqimeve dhe një temperaturë më të njëtrajtshme në dhomëz.

**E rëndësishme** Ndizeni ventilatorin atëherë kur temperatura e ambientit kalon 25°C.

## Udhëzime dhe këshilla të nevojshme

### Këshilla për kursimin e energjisë

- Mos e hapni shpesh derën e frigoriferit ose mos e lini atë absolutisht të hapur më shumë se ç'duhet.
- Nëse temperatura e ambientit është e lartë, Rregullatori i Temperaturës është

vendosur në përzgjedhjen më të lartë dhe pajisja është e mbushur plot, kompresori mund të punojë pa pushim duke shkaktuar formimin e ngricës ose akullit në aparatin e avullimit. Nëse kjo gjë ndodh, rrotulloni Rregullatorin e Temperaturës drejt një përzgjedhjeje më të ulët për të lejuar

shkrijen automatike dhe si rrjedhojë kursimin e konsumit të energjisë.

### **Këshilla për ftohjen e ushqimeve të freskëta**

Për të arritur një funksionim më të mirë:

- mos depozitoni ushqime të ngrohta apo lëngje që avullojnë në ftohës;
- mbuloni me kapak ose mbështillni ushqimin, veçanërisht nëse ka një erë të fortë;
- vendoseni ushqimin në mënyrë të tillë që ajri të qarkullojë lirshëm rreth tij.

### **Këshilla për ftohjen**

Këshilla të nevojshme:

Mish (të gjitha llojet) : mbështillni në qeska polietileni dhe vendosini mbi raftin e xhamit që ndodhet mbi sirtarin e perimeve.

Për siguri, ruajini në këtë mënyrë jo më shumë se një ose dy ditë.

Ushqime të gatuar, gata të ftohta etj.: këto duhet të mbulohen dhe mund të vendosen në çdo raft.

Frutat dhe perimet: këto duhet të pastrohen mirë dhe të vendosen në sirtarin e posaçëm.

Kur bie në kontakt, lëngu i limonit mund të çngjyrosë pjesët plastike të frigoriferit. Si rrjedhim, rekomandohet që t'i mbani agrumet në enë të veçanta.

Gjalpi dhe djathi: këto duhet të vendosen në mbajtëset e posaçme hermetike ose të mbështjella në letër alumini ose qeska prej polietileni, për të lejuar brenda sa më pak ajër të jetë e mundur.

Shisheet: këto duhet të kenë një kapak dhe duhet të vendosen në mbajtësen e shisheve të dera.

Bananet, patatet, qepët dhe hudhrat, nëse nuk janë të paketuara, nuk duhet të mbahet në ftohës.

### **Këshilla për ngrirjen**

Për t'ju ndihmuar të kryeni pjesën më të madhe të procesit të ngrirjes, ja tek keni disa këshilla të rëndësishme:

- sasia maksimale e ushqimit që mund të ngrihet në 24 orë. është shfaqur në tabelën e vlerave;

- procesi i ngrirjes zgjat 24 orë. Nuk duhet shtuar ushqim tjetër për t'u ngrirë gjatë kësaj periudhe;
- ngrini vetëm ushqime të cilësisë më të lartë, të freskëta dhe të pastruara mirë;
- përgatitni ushqimin në racione të vogla për të mundësuar ngrirjen e tij të shpejtë dhe të plotë si dhe për të bërë të mundur si rrjedhojë shkrijen e tij në sasinë e dëshiruar;
- mbështilleni ushqimin me letër alumini ose polietileni dhe sigurohuni që paketimi të jetë hermetik;
- mos lejoni ushqimet e freskëta, të pangrira, të prekin ushqimet që janë tashmë të ngrira, në mënyrë që të shmangni një rritje temperature të këtyre të fundit;
- ushqimet pa dhjamë ruhen më mirë dhe më gjatë se ushqimet e yndyrshme; kripa redukton jetëgjatësinë e ruajtjes së ushqimit;
- akujt e ujit, nëse konsumohen menjëherë pas nxjerrjes nga dhomëza e ngrirjes, mund të shkaktojnë djegie të lëkurës nga ngrirja;
- është e këshillueshme të shënoni në çdo pako ushqimi të ngrirë datën e ngrirjes, për të pasur parasysh kohën e ruajtjes.

### **Këshilla për depozitim të ushqimeve të ngrira**

Për të arritur një rendiment sa më të lartë nga kjo pajisje, duhet:

- të siguroheni që ushqimet e ngrira që keni blerë të jenë ruajtur siç duhet nga shitësi;
- të siguroheni që ushqimet e ngrira të transportohen nga dyqani në ngrirës brenda një kohe sa më të shkurtër;
- të mos e hapni shpesh derën e frigoriferit ose mos e lini atë hapur më shumë se ç'duhet;
- pasi e keni shkryer, ushqimi priset shpejt dhe nuk mund të ngrihet sërish;
- mos e tejkaloni periudhën e ruajtjes të përcaktuar nga prodhuesi i ushqimit.

## Kujdesi dhe pastrimi

**!** **Kujdes** Shkëputeni nga korrenti pajisjen përpara se të kryeni çdo veprim mirëmbajtjeje.

**🌿** Kjo pajisje përmban hidrokarbure brenda njësisë ftohëse; për këtë arsye, mirëmbajtja dhe rimbushja duhet të kryhen vetëm nga teknikë të autorizuar.

### Procedura e larjes së shpërndarësit të ujit

Pajisja duhet pastruar rregullisht:

- pastroni brendësinë dhe aksesorët me ujë të vakët dhe me pak sapun.
- kontrolloni rregullisht bravat e derës dhe pastrojini ato për t'u siguruar që janë të pastra dhe nuk kanë papastërti.
- shpëlajeni dhe thajeni tërësisht.

**E rëndësishme** Mos tërhiqni, lëvizni apo dëmtoni asnjë tub dhe/ose kabllot brenda kabinetit.

Mos përdorni kurrë detergjent, pluhura gërryese, produkte pastruese me shumë erë të mirë ose pastrues me dyllë për të pastruar brendësinë e pajisjes, pasi këto mund të dëmtojnë sipërfaqet dhe mund të lënë një erë të fortë.

Pastroni kondensatorin (skarën e zezë) dhe kompresorin në pjesën e pasme të pajisjes, me një furçë. Ky veprim do të përmirësojë rendimentin e pajisjes dhe do të kursejë konsumin e energjisë.

**E rëndësishme** Kujdesuni që të mos dëmtoni sistemin ftohës.


Shumë pastrues për sipërfaqe kuzhine përmbajnë kimikate që mund të sulmojnë/dëmtojnë lëndën plastike të përdorur në këtë pajisje. Për këtë arsye, këshillohet që veshja e jashtme e kësaj pajisjeje të pastrohet vetëm me ujë të ngrohtë me pak lëng larës. Pas pastrimit, rilidheni pajisjen me ushqimin kryesor.

### Shkrirja e frigoriferit

Bryma eliminohet automatikisht nga avulluesi i dhomëzës së ftohësit sa herë që

kompresori ndalon, gjatë përdorimit normal. Uji i shkrirjes kullon nëpërmjet një zgavre në një mbajtëse të posaçme që ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes, mbi kompresorin e motorit, ku dhe avullon.

Është e rëndësishme të pastroni periodikisht vrimën kulluese të ujit të shkrirjes, që ndodhet në mes të kanalit të dhomëzës së ftohjes, për të parandaluar që uji të rrjedhë jashtë e të pikojë mbi ujë. Përdorni pastruesin e posaçëm që ju është dhënë, të cilin do ta gjeni të futur në vrimën e kullimit.



### Shkrirja e ngrirësit

Një sasi e caktuar ngrice do të formohet gjithmonë në raftet e ngrirësit dhe rreth e përçark dhomëzës së sipërme. Shkrini ngrirësin kur shtresa e brymës arrin një trashësi prej 3-5 mm.

**E rëndësishme** Rreth 12 orë para shkrirjes, vendoseni rregullatorin e Temperaturës në përzgjedhjet më të larta, në mënyrë që të formohet një rezervë e mjaftueshme ftohjeje për ndërprerjen e operacionit.


Për të hequr brymën e formuar, ndiqni udhëzimet e mëposhtme:

1. Fikni pajisjen.
2. Hiqni çdo ushqim nga brenda, paketojini me disa shtresa gazete dhe vendosini në një vend të freskët.

**!** **Kujdes** Mos i prekni me duar të zbuluara ushqimet e ngrira. Këto ushqime mund të ngrinë duart.



3. Lëreni derën hapur dhe vendoseni kruajtësen plastike në shtresën e përshtatshme në bazamentin e



qendrës, duke vendosur një tas poshtë për të mbledhur ujin e shkrirë

- i** Për të shpejtuar procesin e shkrirjes, vendosni një tenxhere me ujë të ngrohtë në dhomëzën e ngrirësit. Përveç kësaj, hiqni copëzat e akullit që plasariten përpara se të ketë përfunduar shkrija.

4. Kur ka përfunduar shkrija, thani pjesën e brendshme mirë dhe mbajeni kruajtësen për ta përdorur sërish në të ardhmen.
5. Ndizni pajisjen.
6. Pas dy ose tre orësh, rivendosni brenda në dhomëz ushqimet që hoqët më parë.

**!** **Paralajmërim** Mos përdorni kurrë vegla metalike me majë për të kruajtur brymën nga avulluesi pasi mund ta dëmtoni atë.

## Si të veprojmë nëse...

**!** **Paralajmërim** Përpara se të kryeni veprime për mirëmbajtjen e pajisjes, hiqeni atë nga priza. Vetëm electricistët e kualifikuar ose personat kompetentë duhet të merren me rregullimet apo defektet që nuk janë në këtë manual.

Mos përdorni asnjë pajisje mekanike apo mjete artificiale për të përshpejtuar procesin e shkrirjes, veç atyre të rekomanduara nga prodhuesi.

Ngritja e temperaturës së pakove të ushqimit të ngrirë, gjatë shkrirjes, mund t'i shkurtojë jetën ruajtjes së ushqimit.

### Kohë të gjata mos-përdorimi

Kur pajisja nuk përdoret për periudha të gjata, merrni masat paraprake të mëposhtme:

- **shkëputeni pajisjen nga energjia elektrike;**
- nxirrni jashtë gjithë ushqimet;
- shkrini (nëse është parashikuar) dhe pastroni pajisjen dhe gjithë aksesorët e saj
- lëreni derën/dyert pak hapur për të shmangur formimin e erërave të pakëndshme.

Nëse pajisjen do ta mbani të ndezur, kërkojini dikujt të kontrollojë herë pas herë për të shmangur prishjen e ushqimit brenda, në rast të luhatjeve elektrike.

**E rëndësishme** Gjatë përdorimit normal dëgjojen disa tinguj (nga kompresori, qarkullimi i lëndës ftohëse).


Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
<b>Pajisja nuk punon. Llamba nuk funksionon.</b>	Pajisja është e fikur.	Ndizni pajisjen.
	Spina nuk është futur mirë në prizë.	Futeni spinën mirë në prizë.
	Pajisja nuk furnizohet me korrent. Në prizën elektrike nuk kalon tension.	Lidhni një pajisje tjetër elektrike në prizë. Kontaktoni një electricist të kualifikuar.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
<b>Llamba nuk punon.</b>	Llamba është në gjendje gatishmërie.	Mbyllni dhe hapni derën.
	Llamba është me defekt.	Shihni kapitullin "Zëvendësimi i llambës".
<b>Kompresori funksionon vazhdimisht.</b>	Temperatura nuk është vendosur si duhet.	Vendosni një temperaturë më të lartë.
	Dera nuk është mbyllur mirë.	Shihni kapitullin "Mbyllja e derës".
	Dera është hapur shumë shpesh.	Mos e mbani derën hapur më shumë se ç'duhet.
	Temperatura e produkteve është tepër e lartë.	Lëreni temperaturën e produkteve të bjerë në temperaturën e ambientit, përpara se ta lini në ruajtje.
	Temperatura e dhomës është tepër e lartë.	Ulni temperaturën e dhomës.
<b>Në pllakën e pasme të frigoriferit rrjedh ujë.</b>	Gjatë procesit automatik të shkrirjes, bryma shkrin në pllakën e pasme.	Kjo është normale.
<b>Brenda në frigorifer rrjedh ujë.</b>	Vrima e daljes së ujit është bllokuar.	Pastroni vrimën e daljes së ujit.
	Produktet e pengojnë ujin të rrjedhë në kolektorin e ujit.	Sigurohuni që produktet të mos prekin pllakën e pasme.
<b>Uji rrjedh në dysheme.</b>	Uji i shkrirë që del jashtë nuk shkon në tabakanë avulluese që ndodhet mbi kompresor.	Bashkoni tubin e daljes së ujit të shkrirë me tabakanë avulluese.
<b>Temperatura në pajisje është tepër e ulët.</b>	Rregulluesi i temperaturës nuk është regjistruar si duhet.	Vendosni një temperaturë më të lartë.
<b>Temperatura në pajisje është tepër e lartë.</b>	Rregulluesi i temperaturës nuk është regjistruar si duhet.	Vendosni një temperaturë më të ulët.

## Zëvendësimi i llambushkës

 **Kujdes** Shkëputeni pajisjen nga priza.

Hiqni vidhën nga kapaku i llambës.  
 Hiqni kapakun e llambës (referojuni figurës).  
 Zëvendësoni llambën me një tjetër të së njëjtës fuqi dhe të projektuar enkas për pajisjet elektroshtëpiake (fuqia maksimale tregohet në mbështjellën e llambës).  
 Montoni kapakun e llambës.  
 Shtrëngoni vidhën te kapaku i llambës.  
 Futeni në prizë pajisjen.  
 Hapni derën.  
 Sigurohuni që llamba të ndizet.



## Mbyllja e derës

1. Pastroni guarnicionin e derës.
2. Nëse është e nevojshme, rregulloni derën. Shihni paragrafin "Instalimi".
3. Nëse është e nevojshme, zëvendësoni guarnicionet defektoze të derës. Lidhuni me Qendrën e Shërbimit.

## Të dhëna teknike

Dimensionet e folesë		
	Lartësia	1780 mm
	Gjerësia	560 mm
	Thellësia	550 mm
Koha në rritje		24 h
Tensioni		230-240 V
Frekuenca		50 Hz

Të dhënat teknike ndodhe në tabelën e vlerave që gjendet në anë të majtë brenda pajisjes dhe në etiketën e energjisë.

## Instalimi

**!** **Kujdes** Lexoni me kujdes kapitullin "Të dhëna për sigurinë" për sigurinë tuaj si dhe për një përdorim të saktë të pajisjes, përpara se të instaloni atë.

[www.zanussi.com](http://www.zanussi.com)

## Pozicionimi


Instalojeni këtë pajisje në një vend ku temperatura e ambientit përputhet me klasën

e klimës që tregohet në tabelën e vlerave në pajisje:


Klasa e klimës	Temperatura e ambientit
SN	+10°C deri + 32°C
N	+16°C deri + 32°C
ST	+16°C deri + 38°C
T	+16°C deri + 43°C

### Lidhja elektrike


Përpara se ta futni pajisjen në prizë, sigurohuni që voltazhi dhe frekuenca që tregohet në tabelën e vlerave përputhet me të dhënat e rrymës së shtëpisë tuaj. Pajisja duhet tokëzuar. Spina e kabllitkablos tsë ushqimit është e pajisur me një kontakt,



- Lironi vidhën e sipërme dhe hiqni ndarësin.
- Hiqni mbërtheckën e sipërme dhe derën e sipërme.




- Lironi menteshën e mesit.



- Hiqni derën e poshtme.
- Lironi vidhën e poshtme.

### Nevojat për ventilim

Qarkullimi i ajrit mbrapa pajisjes duhet të jetë i mjaftueshëm.



pikërisht për këtë qëllim. Nëse spina e ushqimit të shtëpisë nuk është e tokëzuar, lidhjeni pajisjen në një prizë të veçantë të tokëzuar në përputhje me rregullat në fuqi, duke u këshilluar me një elektricistelekttricist. Prodhuesi refuzon të marrë përsipër gjithë përgjegjësinë nëse nuk ndiqen masat paraprake të mësipërme. Kjo pajisja është në përputhje me E.E.C. - Direktivat

### Ndryshimi i drejtimit të derës

Dera e pajisjes hapet nga e djathta. Nëse doni të hapni derën nga e majta, ndiqni këta hapa përpara se të instaloni pajisjen:


Në krahun e kundërt:

- Vendosni vidhën e poshtme.
- Montoni derën e poshtme.
- Shtërngoni menteshën e mesit.
- Montoni derën e sipërme.
- Shtërngoni ndarësen dhe vidhën e sipërme.


### Instalimi i pajisjes

**!** **Kujdes** Sigurohuni që kabli kryesor i ushqimit të lëvizë lirshëm.


Ndiqni hapat e mëposhtëm:




Nëse është e nevojshme, priteni shiritin ngjites dhe më pas aplikojeni në pajisje siç tregohet në figurë.




Instaloni pajisjen në folenë përkatëse. Shtyjeni pajisjen në drejtim të shigjetave (1) derisa kapaku i sipërm të ndalojë pas mobilies së kuzhinës. Shtyjeni pajisjen në drejtim të shigjetave (2) pas dollapit në të kundërt të menteshës.




Sistemoni pajisjen në folenë përkatëse. Sigurohuni që largësia midis pajisjes dhe pjesës ballore të dollapit të jetë 44 mm. Kapaku i menteshës së poshtme (në çantën e aksesorëve) siguron që largësia midis mobilieve të kuzhinës dhe pajisjes është e saktë. Sigurohuni që boshllëku midis pajisjes dhe pjesës ballore të dollapit të jetë 4 mm. Hapni derën. Vendoseni kapakun e menteshës së poshtme në vend.




Fiksojeni pajisjen në folenë përkatëse me 4 vidha.



Hiqni pjesën e duhur nga kapaku i menteshës (E). Sigurohuni që të hiqni pjesën DX, në rast të vendosjes së menteshës në të djathtë, dhe SX në rastin e kundërt.




Vendosini kapakët (C, D) në zgavrat dhe vrimat e menteshës. Montoni rretjetën e ventilimit (B). Vendosini kapakët e menteshës (E) në menteshë.




Nëse pajisja duhet të lidhet anash në derën e mobilies së kuzhinës:


1. Lironi vidhat e pjesës (G) dhe shtyjeni pjesën (G) deri te mobilia e kuzhinës.
2. Shtërngoni vidhat e pjesës (G) sërish.
3. Vendosini pjesën (H) te pjesa (G).




Shkëputni pjesët (Ha), (Hb), (Hc) dhe (Hd).




Montoni pjesën (Ha) në pjesën e brendshme të mobilies së kuzhinës.




Shtyni pjesën (Hc) në pjesën (Ha).




Hapni derën e pajisjes dhe derën e mobilies së kuzhinës në një kënd 90°. Vendosni kuadratin e vogël (Hb) në udhëzuesin (Ha). Bashkoni derën e pajisjes dhe derën e dollapit dhe shënoni vrimat.



Hiqni mbajtëset dhe shënoni një largësi prej 8 mm nga qoshja e jashtme e derës ku duhet të futet gozhda (K).



Vendoseni kuadratin e vogël në udhëzues sërish dhe fiksojeni atë me vidhat e marra bashkë me pajisjen. Drejtoni derën e dollapit të kuzhinës dhe derën e pajisjes duke rregulluar pjesën Hb.



Shtyni pjesën (Hd) në pjesën (Hb).

Bëni një kontroll përfundimtar për t'u siguruar që:

- Të gjitha vidhat janë shtrënguar.
- Shiriti ngjitës magnetik është puthitur mirë në dollap.

## Çështje që lidhen me ambientin

Ricikloni materialet me simbolin ♻️ . Vendoseni ambalazhin te konteneriet e riciklimit nëse ka. Ndhmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e

**E rëndësishme** Nëse temperatura e ambientit është e ulët (për shembull, në Dimër), përmasat e rondelës ulen. Përmasat e rondeles rriten kur rritet temperatura e ambientit.

mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni pajisjet e shënuara me simbolin ⚡ e mbeturinës shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

# Содержание

Указания по безопасности _____	16	Уход и очистка _____	22
Описание работы _____	19	Что делать, если ... _____	24
Первое использование _____	19	Технические данные _____	26
Ежедневное использование _____	20	Установка _____	26
Полезные советы _____	21	Забота об окружающей среде _____	30

Право на изменения сохраняется.

## Указания по безопасности

Для обеспечения собственной безопасности и правильной эксплуатации прибора, перед его установкой и первым использованием внимательно прочитайте данное руководство, не пропуская рекомендации и предупреждения. Чтобы избежать нежелательных ошибок и несчастных случаев, важно, чтобы все, кто пользуется данным прибором, подробно ознакомились с его работой и правилами техники безопасности. Сохраните настоящее руководство и в случае продажи прибора или его передачи в пользование другому лицу передайте вместе с ним и данное руководство, чтобы новый пользователь получил соответствующую информацию о правильной эксплуатации и правилах техники безопасности.

В интересах безопасности людей и имущества соблюдайте меры предосторожности, указанные в настоящем руководстве, так как производитель не несет ответственности за убытки, вызванные несоблюдением указанных мер.

### **Безопасность детей и лиц с ограниченными возможностями**

- Данное изделие не предназначено для эксплуатации лицами (в том числе детьми) с ограниченными физическими, сенсорными или умственными способностями или с недостаточным опытом или знаниями без присмотра лица, отвечающего за их безопасность, или получения от него соответствующих инструкций, позволяющих им безопасно эксплуатировать его.

Необходимо следить за тем, чтобы дети не играли с прибором.

- Держите все упаковочные материалы в недоступном для детей месте. Существует опасность удушья.
- Если прибор больше не нужен, выньте вилку из розетки, обрежьте шнур питания (как можно ближе к прибору) и снимите дверцу, чтобы дети, играя, не получили удар током или не заперлись внутри прибора.
- Если данный прибор (имеющий магнитное уплотнение дверцы) предназначен для замены старого холодильника с пружинным замком (защелкой) дверцы или крышки, перед утилизацией старого холодильника обязательно выведите замок из строя. Это позволит исключить превращение его в смертельную ловушку для детей.

### **Общие правила техники безопасности**


#### **ВНИМАНИЕ!**

